

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI FILLOR**



## **PUNIM DIPLOME**

**Tema: Analizë morfologjike e ndajfoljeve në veprën**

**“Djaloshi i çuditshëm”- Qamil Batalli**

**Mentorja:**

**Prof.Asoc.Dr. Sindorela Doli-Kryeziu**

**Kandidatja:**

**Arnisa Rogova**

**Gjakovë, 2020**

Ky punim diplome u mbajt më: \_\_\_\_\_

Para komisionit vlerësues:

1. \_\_\_\_\_ Kryetar-e
2. \_\_\_\_\_ Anëtar
3. \_\_\_\_\_ Anëtar

Komisioni vlerësues e vlerësoi punimin me notë \_\_\_\_\_ ( )

# Dedikuar

**Atyre që më rritën e më edukuan në frymën e arsimit  
dhe më frymëzuan të vazhdoj profesionin e mësimdhënies**

**- Familjes**

## **Falënderime**

Për kontributin dhe angazhimin e palodhshëm gjatë këtyre katër viteve të studimit fillimisht dua të falënderoj gjithë stafin profesional të profesorëve të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”.

Një falënderim shumë i veçantë i dedikohet udhëheqëses shkencore Prof.Asoc.Dr. Sindorela Doli-Kryeziu e cila gjatë këtyre viteve na motivoi dhe mbështeti.Është një shembull për të vazhduar përpara.

Falënderime të pakufishme familjes sime për mbështetjen, durimin dhe mirëkuptimin që kishin gjatë këtyre katër viteve. Falënderimi i dedikohet edhe shoqërisë për përkrahjen dhe kohën që kaluam së bashku.

**Gjithmonë falënderuese!**

# PËRMBLEDHJE

ABSTRAKT .....	6
Hyrje .....	7
1. GJUHËSIA DHE DEGËT E SAJ .....	8
1.1 Gjuha.....	8
1.2 Fonetika.....	8
1.3 Leksikologjia.....	9
1.4 Gramatika.....	9
1.4.1 Morfologjia .....	10
1.4.2 Sintaksa .....	10
2. NDAJFOLJA- Njohuri të përgjithëshme .....	11
2.1 Ndajfolja .....	11
2.2 Klasifikimi i ndajfoljeve .....	12
2.2.1 Ndajfoljet Përcaktore .....	12
2.2.1.1 Ndajfoljet e mënyrës .....	13
2.2.1.2 Ndajfoljet e sasisë .....	14
2.2.2 Ndajfoljet Rrethanore.....	14
2.2.2.1 Ndajfolet e kohës .....	15
2.2.2.2 Ndajfoljet e vendit.....	16
2.2.2.3 Ndajfoljet e shkakut .....	17
2.3 Shkallët e Ndajfoljeve- Njohuri të përgjithshme .....	18
2.3.1 Shkallët e ndajfoljeve.....	18
2.3.2 Shkalla krahasore .....	19
2.3.3 Shkalla sipërore.....	21
2.4 Formimi i Ndajfoljeve.....	22
2.4.1 Ndajfolje të parme.....	22
2.4.2 Ndajfolje të prejardhura .....	22
2.4.3 Ndajfoljet e përngjitura .....	26
2.4.4 Lokucione ndajfoljore .....	26
3. JETA DHE VEPRA E AUTORIT .....	29
3.1 Qamil Batalli.....	29
3.2 Vepra “ Djaloshi i çuditshëm” .....	30
PËRFUNDIMI .....	31
LITERATURA .....	32

## ABSTRAKT

Temë studimi në këtë punim është analiza morfologjike e ndajfoljeve në romanin për fëmijë e autorit Qamil Batalli “Djaloshi i çuditshëm”. Objekt studimi për morfologjinë është fjala e cila e vështron si njësi për të emërtuar një send, një cilësi, një veprim apo një rrethanë. Në bazë të veçorive morfologjike, pjesët e ligjeratës ndahen në pesë të ndryshueshme dhe pesë të pandryshueshme. Në pjesët e pandryshueshme të ligjeratës bën pjesë edhe ndajfolja e cila as nuk lakohet dhe as nuk zgjedhohet. Ndajfolja emërton një tipar të veprimit ose të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie apo të një rrethane ose intensitetin e veprimit.

Ndajfolja është objekt studimi në çdo gramatikë shkollore, prandaj jam munduar që në këtë punim të trajtoj formën e përdorimit dhe rolin që luajnë ndajfoljet në shprehjen e mendimeve gjatë shtjellimit të tyre në të folur apo në të shkruar.

Në këtë punim do të përpiqem të paraqes shkurtimisht disa njohuri të përgjithshme për gjuhën dhe degët kryesore të saj si: fonetika, leksikologjia dhe gramatika që ndahet në morfologji dhe sintaksë. Do të flasim për njohuritë e përgjithshme të ndajfoljeve dhe përdorimin e tyre, klasifikimin i tyre sipas funksionit që kryejnë në fjali, si dhe për veçoritë që ato kanë për t’u përdorur në shkallë të ndryshme dhe mënyrat e formimit të saj.

Gjithashtu në këtë punim do të gjeni disa fjalë për jetën e autorit të njohur që ka shkruar shumë vepra të njohura për fëmijë, Qamil Batalli. Libri që kam përzgjedhur për analizimin e ndajfoljeve përmban tregime me histori të ndryshme që kanë karakter edukativ dhe ia vlenë të lexohet nga fëmijët.

**Fjalët kyçe:** *analizë, morfologji, ndajfolje, klasifikim, formim, etj.*

## Hyrje

Gjuha është një mjet me të cilën njerëzit komunikojnë dhe shkëmbejnë mendimet. Kur duam t'i shfaqim ndonjërit një dëshirë, kur duam të kërkojmë një mendim apo të kërkojmë ndihmë, përdorim gjuhën si mjet për t'u marrë vesh. Pra, këtë mjet kaq të rëndësishëm e ka vetëm njeriu i cili është një qenie shoqërore dhe nuk mund të jetojë jashtë shoqërisë. Duke jetuar dhe duke punuar së bashku, ndjen nevojën që të mirren vesh dhe të shkëmbejnë mendime në mes tyre. Kështu, nevoja i bëri njerëzit të krijojnë mjetin më të rëndësishëm me anë të të cilit mund të kuptojnë njëri tjetrin – gjuhën.

Çdo popull ka gjuhën e vet të cilën e kanë trashëguar nga të parët. Në botë fliten gjuhë të ndryshme të cilat dallojnë përmes fjalorit dhe strukturës gramatikore të tyre.

Fjalori i një gjuhe pasurohet gjatë zhvillimit të shoqërisë. Mirëpo me kalimin e kohës shumë fjalë të ndryshme shuhen apo dalin jashtëpërdorimit dhe fjalë të reja hyjnë brenda strukturës së gjuhës duke e pasuruar atë me shprehje dhe nocione të reja. Me anë të fjalëve të fjalorit formojmë fjali dhe përmes fjalive ne shprehim mendimet tona. Pra, që të kuptohem, duke iu përshtatur rregullave gramatikore të gjuhës. Me strukturë gramatikore kuptojmë se si fjalët lidhen në mes tyre në fjali për të krijuar mendime të plota...

# 1. GJUHËSIA DHE DEGËT E SAJ

## 1.1 Gjuha

Gjuha është mjete kryesor për komunikim dhe përmes gjuhës janë zhvilluar të gjitha shkencat. Gjuha ka filluar të studiohet qysh në kohët e lashta të historisë së njerëzimit. Shkenca e cila merret me studimin e gjuhës quhet gjuhësi apo linguistikë, që do të thotë shkenca mbi gjuhën. Kjo shkencë studion veçoritë e përgjithshme të gjuhës që nga zanafilla si dhe pasurimin e zhvillimin nëpër etapa të ndryshme nëpër të cilat kalon ai popull që e flet atë gjuhë të caktuar. Degët kryesore të gjuhës janë: fonetika, leksikologjia dhe gramatika.<sup>1</sup>

## 1.2 Fonetika

Fonetika rrjedh nga greqishtja që do të thotë fone – tingull. Fonetika e gjuhës shqipe merret me studimin e sistemit të tingujve apo shkronjave të një gjuhe. Gjuha Shqipe ka 36 shkronja të cilat ndahen në 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore, që paraqesin bazën kryesore për ndërtimin e të gjitha fjalëve të gjuhës shqipe. Zanoret klasifikohen sipas gjatësisë së intensitetit të shqiptimit të tyre. Thirren zanore sepse gjatë shqiptimit të tyre nuk hasin në pengesa në aparatit e të folurit, pra gojës. Bashkëtingëlloret për ndryshim të zanoreve, ato hasin në pengesa të ndryshme në aparatit e të folurit dhe janë të pazëshme.

---

<sup>1</sup> Shaban Demiraj, “ Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974, fq.6



### 1.3 Leksikologjia

Leksikologjia rrjedh nga greqishtja lexis – fjalë dhe logos – dituri. Leksikologjia është degë e gjuhësisë e cila paraqet tërësinë e fjalëve të një gjuhe të caktuar që përdoren gjatë komunikimit apo shkrimit të një gjuhe. Leksikologjia e Gjuhës Shqipe është shumë e pasur me fjalë dhe shprehje nga më të ndryshmet që përdoren edhe në gjuhën standarde por edhe në dialekte të ndryshme, një pjesë e të cilave janë shumë të lashta. Disa prej këtyre fjalëve përdoren ashtu si janë trashëguar nga të parët tanë. Por një kategori fjalësh janë krijuar përmes mjeteve gjuhësore si parashtesa, mbaresa, fjalë të përngjitura etj. të cilat janë krijuar për të shprehur mendime më të larta dhe për të plotësuar nevojën për fjalë të reja. Një kategori fjalësh janë të huazuara nga gjuhë të tjera sidomos për emërtimin e zbulimeve të vonshme të teknikës dhe teknologjisë që janë të nevojshme për komunikim.

Leksikologët shqipëtarë janë marrë me hartimin e fjalorëve një gjuhësh apo shumë gjuhësh por edhe fjalor dialektologjik, ku përfshihet leksiku i përgjithshëm i Gjuhës Shqipe. Fjalori shpjegues i gjuhës Shqipe i botuar në vitin 1980, është fjalor i tipit të mesëm dhe në të janë të përfshira 46.000 fjalë.

### 1.4 Gramatika

Gramatika rrjedh nga fjala greke që do të thotë arti i të shkruarit. Është degë e gjuhësisë që studion rregullat e ndryshimit të fjalëve dhe të bashkimit të tyre në fjali. Gramatika ndahet në dy pjesë: në morfologji dhe në sintaksë. Morfologjia dhe sintaksa gërshetohen dhe e plotësojnë njëra - tjetrën.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Shaban Demiraj, “ Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974, fq.7

## 1.4.1 Morfologjia

Morfologjia rrjedh nga fjala greke morfe – formë dhe logos – fjalë, dije. Për t'i studiuar në tërësi fjalët që formojnë një gjuhë sipas kuptimit, rolit dhe funksionit të fjalëve, për lehtësi studimi, të gjitha fjalët e një gjuhe ndahen në dhjetë grupe apo pjesë të ligjeratës. Këto ndahen në pjesë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Pesë janë të ndryshueshme dhe pesë të pandryshueshme. Pjesët e ndryshueshme të ligjeratës i nënshtrohen rregullave të veçanta të cilat lakohen apo zgjedhohen kurse pjesët e pandryshueshme të ligjeratës janë fjalë të ngurosura dhe përdoren të pandryshueshme por që përmbushin nevojën e të shprehurit të mendimeve në bashkëveprim me pjesët e ndryshueshme të ligjeratës. Të ndryshueshme janë: emri, mbiemri, numërori, përemri dhe folja kurse pjesët e pandryshueshme të ligjeratës janë: ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma.<sup>3</sup>

Parimet kryesore që duhen mbajtur kurdoherë parasysh në hartimin e morfologjisë të gjuhës shqipe janë:

- 1) Vështrimi i dukurive gjuhësore në lidhjet e tyre reciproke. Kështu, dukuritë morfologjike duhen parë në lidhje të ngushtë jo vetëm brenda strukturës morfologjike, por edhe brenda strukturës gjuhësore si sistem.
- 2) Vështrimi i dukurive morfologjike në evolucionin e tyre të vazhdueshëm. Ky parim është me rëndësi themelore sidomos për krahasimin e jashtëm të strukturës morfologjike të shqipes.<sup>4</sup>

## 1.4.2 Sintaksa

Sintaksa rrjedh nga greqishtja sintaksis - bashkërenditje. Është pjesë e gramatikës që studion rregullat e bashkimit të fjalëve në fjali dhe fjalive në periudhë.<sup>5</sup>

---

<sup>3</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 29-30

<sup>4</sup> Shaban Demiraj, “Morfologjia Historike e Gjuhës Shqipe”, Botimi “Ramiz Sadiku” Prizren, 1980, fq. 15-16

<sup>5</sup> Shaban Demiraj, “Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974, fq. 7

## 2. NDAJFOLJA - Njohuri të përgjithshme

### 2.1 Ndajfolja

Ndajfolja është pjesë e pandyshueshme e ligjeratës e cila emërton një tipar të një veprimi apo të një gjendjeje. Rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie apo të një rrethane ose intensitetin e veprimit. Ndajfolja zakonisht qëndron pas foljes.<sup>6</sup> Ajo ka vetëm kategorinë gramatikore të shkallës e cila shprehet në mënyrë analitike, ka kuptim të mëvetësishëm leksikor dhe në fjali përdoret si gjymtyrë më vete. Për ndryshim të mbiemrit që është pjesë e ndyshueshme e ligjeratës dhe që varet nga emri, ndajfolja është gjymtyrë më vete dhe brenda tekstit bënë një jetë të pavarur por ashtu si mbiemri ka shkallën gramatikore. Veçoritë morfologjike të ndajfoljeve janë:

- a) Lidhja fjalëformuese kuptimore me pjesët e tjera të ligjeratës;
- b) Kanë sistem të veçantë të prapashtesave kur ndajfoljet janë të prejardhura;
- c) Numri i madh i lokucioneve.<sup>7</sup>

Ndajfoljet rregullisht qëndrojnë pranë një foljeje:

Shembull: *Fjala “të vdesim” tingëlloi dhimbshëm në zemrën e Lirianit”.*

pranë një mbiemri:

Shembull: *Ai tundi kokën e madhe me pikëllim.*

apo një ndajfolje tjetër:

Shembull: *Ka jetuar moti, para shumë e shumë vitesh. (faqe 121)*

Në kushte të caktuara ndajfolja përdoret pranë një emri kryesisht prejfoljor e rrallë pranë një emri jo prejfoljor:

Shembull: *Kurrë nuk i shkonte mendja se mund ta mashtronin ashtu.*

---

<sup>6</sup> Gjovalin Shkurtaj, “Shqipja e Sotme”, Shtëpia Botuese Universitare U.F.O Press, Tiranë, 2010, fq. 441

<sup>7</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 357

## 2.2 Klasifikimi i ndajfoljeve

Ndajfoljet sipas funksionit që kryejnë në fjali ndahen në:

- ❖ Ndajfolje përcaktore dhe
- ❖ Ndajfolje rrethimore

### 2.2.1 Ndajfoljet Përcaktore

Ndajfoljet përcaktore emërtojnë tiparin e një veprimi të shprehur nga folja si dhe nga shkalla e intensitetit të këtij veprimi apo të një tipari. Brenda grupit të ndajfoljeve përcaktore dallojmë:

- Ndajfoljet e mënyrës
- Ndajfoljet e sasisë<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë,2002, fq.358-360

### 2.2.1.1 Ndajfoljet e mënyrës

Quhen ndajfolje mënyre sepse tregojnë mënyrën se si kryhet veprimi. Termi mënyrë ka kuptime të shumta dhe mund të vihen në dukje këto lloje:

- Ndajfoljet e mënyrës të cilat përcaktojnë cilësinë e veprimit: mirë, keq, bukur, ëmbël, qartë, thjesht, vështirë, etj.  
Shembull: *Vogëlushes i rridhnin fjalët nga goja, **ëmbël** si zëri i bilbilit.*
- Ndajfolje të cilat tregojnë ecurinë e procesit të veprimit: menjëherë, papritur, vazhdimisht, shpesh, pak nga pak, etj.  
Shembull: *Shokët i vërsuleshin **vrullshëm**. Mirëpo, babai sot ishte vonuar për në punë. Vishej shpejt. Donte të nisej sa më parë.* (Faqe 96)
- Ndajfolje të cilat tregojnë përmasa: gjatë, gjërë, thellë, cekët, ulët, etj.  
Shembull: *Bregu iu duk tejet **larg**, sikur nuk do të mund ta arrinte kurrë.*
- Ndajfoljet të cilat kanë kuptimin e mënyrës dhe janë të formuara me prapashtesën – (i)sht. Të cilat janë: artistikisht, hollësisht, teorikisht, bujarisht, etj.  
Shembull: *Shokët përpiqeshin ta bindnin duke i spjeguar **hollësisht** për rrethanat e asaj ngjarjeje.*<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Bahri Beci, “Gramatika e Gjuhës Shqipe” Tiranë, 2010, fq.156

### 2.2.1.2 Ndajfoljet e sasisë

Quhen ndajfolje sasië pasi tregojnë sasinë. Këto ndajfolje përcaktojnë foljen duke shprehur intensitetin e shkallës së veprimit si dhe të sasisë.

Ndajfoljet kryesore të sasisë janë:

- *Shumë, pak, tepër, fort, së tepërmi, dy herë, etj.*, të cilat tregojnë se në ç`masë realizohet veprimi i kryer nga folja referuese.

Shembull: *Vendositë merrte jo më pak se katër krahë suxhuk.*

- *Fort, tepër, njëfish, dyfish, trefish, kaq, mjaft, pak, etj.*, të cilat tregojnë intensitetin ose shkallën e një veprimi apo të një cilësie.

Shembull: *“O Zot, o çudi! Po kjo qenka një pëllëmbë njeri, thoshin ata. Po si mundka të ngarkohet kaq shumë!”<sup>10</sup>*

### 2.2.2 Ndajfoljet Rrethanore

Ndajfoljet rrethanore emërtojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. Sipas kuptimit që kanë ndajfoljet rrethanore ndahen në:

- Ndajfolje kohe
- Ndajfolje vendi
- Ndajfolje shkak

---

<sup>10</sup> Bahri Beci, “Gjuha Shqipe 7”, Pejë, 2004, fq.120

### 2.2.2.1 Ndajfolet e kohës

Ndajfoljet e kohës emërtojnë rrethanat kohore, pra tregojnë kohën kur kryhet apo sa zgjat veprimi i shprehur nga folja apo nga një emër prejfoljor i nyjësuar.

Ndajfoljet e kohës tregojnë:

- Kohën e saktë të kryerjes së veprimit ku përdoren ndajfoljet: *dje, nesër, pardje, sonte, sot, vjet, tani, etj.*  
Shembull: *Do të organizojmë sot një lojë me shokët e klasës. Urta sot ishte gjithë gaz e shend.- Ta merr mendja, sot e ka ditëlindjen...*
- Kohën e papërcaktuar me saktësi e cila mund të shprehet me ndajfolje dhe me lokucione ndajfoljore: *dikur, njëherë, një ditë, brez pas brezi, një mot, një herë e një kohë, së shpejti, etj.*  
Shembull: *Fëmijët shkonin një herë e një kohë në oborrin e shkollës për të luajtur.*
- Kohën se sa zgjat një veprim apo një gjendje dhe përsëritjen rregullisht të një veprimi e cila shprehet me ndajfolje dhe me lokucione ndajfoljore: *gjithmonë, gjithnjë, përnatë, ndonjëherë, shpesh, ditë për ditë, herë pas here, etj.*  
Shembull: *Kur dëgjonte nënë Fatushja se njerëzit pyesnin kohë pas kohe dhe vazhdimisht për të, i shpëtonte nga gëzimi ndonjë pikë loti.*
- Kohën që tregon veprimin e një çasti, përdoren ndajfoljet: *aty për aty, menjëherë, njëherë përnjëherë, etj.*  
Shembull: *Fëmijët u zbehen. Pritnin çastin kur dora e madhe e Jupit do t'i dridhte të gjithë, si ndonjë erë e tërbuar që dridh përnjëherësh krejt lisat e një mali.*
- Sasinë e kohës që duhet për kryerjen e veprimit ose kohën që ka kaluar nga kryerja e tij, e cila shprehet me ndajfolje apo lokucione ndajfoljore: *motmot, një copë herë, një grim, etj.*  
Shembull: *Ra heshtja një copë herë në mes të fëmijëve.*

Si ndajfolje kohe merret edhe fjala pyetëse **kur**, në rast se përdoret nëpër fjali pyetëse të drejta ose të zhdrejta.

Shembull: **Kur** do të vijnë shokët për ta vazhduar lojën?- pyeti Rrezani.

### 2.2.2.2 Ndajfoljet e vendit

Ndajfoljet e vendit tregojnë vendin ku kryhet veprimi apo ku ndodh një ngjarje duke u nisur nga pika orientuese. Disa prej këtyre ndajfoljeve janë: *afër, atje, aty, djathtas, larg, pranë, këtu, rreth*, etj.

Shembull:- *Unë them se **këtu** nuk ka fitues, - të dytë do të mbesin në këmbë - mendonte e treta.*

Disa ndajfolje lokucion mund të tregojnë vendin e kryerjes së veprimit në një mënyrë pak a shumë të papërcaktuar si: *diku, gjëkund, gjithëkund, vende-vende, gjetiu*. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe ndajfoljet si: *anëmbanë, gjithandej, kudo, ngado*, etj.

Shembull: - *Sheshi ishte shtruar **anëmbanë** me lule shumë ngjyrëshe që i kishin sjellur fëmijët...*

Disa prej ndajfoljeve të vendit janë si ndajfolje të kohës që përdoren në fjali mohuese, si pjesë e dytë përforcuese e mohimit. Të tilla janë: *asgjëkund, askundi, gjëkund, kurrkund*.

Shembull: *Shokët që po i priste, nuk dukeshin **askund** .*

Si ndajfolje vendi merren edhe ndajfoljet pyetëse **ku, nga** kur përdoren në fjali pyetëse të drejta dhe të zhdrejta.

Shembull:- ***Nga** erdhën të gjithë këta fëmijë që e mbushën sheshin e shkollës? -pyeti Mirani shokët që i kishte pranë.*



### 2.2.2.3 Ndajfoljet e shkakut

Ndajfoljet e shkakut përdoren kryesisht vetëm në rastet kur shërbejnë si mjet lidhës i një fjalie të varur me një fjali tjetër. Këto nuk janë dalluar si grup më vete në gramatikat e gjuhës shqipe. Arsyeja e mos klasifikimit të tyre ka qenë për shkak të numrit të mangët të tyre dhe kryesisht përdoren në fjali pyetëse të drejta dhe të zhdrejta.

Këto ndajfolje përdoren për të treguar apo për të pyetur për qëllimin apo shkakun e kryerjes së veprimit. Këto janë: **përse, pse**.

Shembull: - *Përse nuk po i përgjigjeshin shokët pyetjeve të tij?*

Tek ndajfoljet e shkakut vend të veçantë zënë fjalët: **prandaj, andaj**, të cilat shpesh përdoren si korrelant me lidhëzat nënrenditëse shkakore: **se, sepse**.

Shembull: *Prandaj të gjithë shokët e nderonin për guximin që tregoi duke i mbrojtur nxënësit më të vegjël prej qenëve të rrugës.*<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë,2002, fq.362-366

## 2.3 Shkallët e Ndajfoljeve- Njohuri të përgjithshme

### 2.3.1 Shkallët e ndajfoljeve

Ndajfoljet dhe mbiemrat kanë një veçori të veçantë që nuk e kanë pjesët e tjera të ligjerates. Edhe ndajfoljet kanë aftësinë për t'u përdorur nëpër shkallë të ndryshme. Ndajfoljet sikur mbiemrat kanë shkallën pohore, krahasore dhe sipërore.<sup>12</sup>

➤ Ndajfoljet e mënyrës:

a) Ndajfoljet e mënyrës që përputhen me trupin e mbiemrave përgjegjës dhe që përdoren edhe në shkallën krahasore dhe në shkallën sipërore: *bukur, hollë, lehtë, shpejtë, rrallë, ashpër, qartë, keq ( më keq), urtë etj.*

Shembull: *Dukej **qartë** se nuk mjaftonte vetëm trimëria për t'u kacafytur me barbarët.*

b) Ndajfoljet e mënyrës që janë të formuara me prapashtesën –(i)sht që përdoren në shkallën krahasore dhe sipërore: *konkretisht, rastësisht, lirisht, hollësisht, etj.*

Shembull: *Tregomë **më konkretisht** për ngjarjen, ju lutem!*

c) Ndajfoljet e mënyrës që vijnë nga pjesoret e foljeve që përdoren në shkallën krahasore e sipërore: *hapur, shkoqur, prerë, shtruar, rrëmbyer, etj.*

Shembull: *Sot Mirani ishte **më i rrëmbyer** në lojë se herave të tjera.*

d) Ndajfoljet e mënyrës të formuar me prapashtesën (-shëm) që përdoren në shkallën krahasore dhe sipërore: *gëzueshëm, natyrshëm, fuqishëm, mendushëm, etj.*

Shembull: *Dukarani atë ditë rrinte **më mendueshëm** dhe nuk fliste me të tjerët.*

e) Lokucionet ndajfoljore që përdoren vetëm në shkallën krahasore të tipit: *për së afërmi, për së largu, për së mbari, etj.*

Shembull: *Vështroi **për së largu** natyrën që ndodhej rreth saj dhe mendonte.*

➤ Ndajfoljet e sasisë: *shumë, tepër, fort*, përdoren në shkallën krahasore ndërsa ndajfolja *pak* përdoret në shkallën krahasore dhe sipërore.

Shembull: *Ndoshta do të ishte më mire të mos e trazonte **më shumë**.* (Faqe 56)

<sup>12</sup> Shaban Demiraj, “ Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974, fq. 194

- Ndajfoljet e vendit që përdoren në shkallën krahasore janë: *anash, andej, brenda, djathtas, majtas, këtej, sipër*, etj. Ndajfoljet e vendit që përdoren në të dy shkallët janë: *afër, larg, poshtë, lart*, etj.  
Shembull: *Urta u ngjit edhe dy shkallë **më lartë** se shoqet e saja.*
- Ndajfoljet e kohës që përdoren në të dy shkallët janë: *para, herët, shpesh vonë*.  
Shembull: *Urta kësaj rradhe kishte dale **më herët** se shoqet e saja në shkollë.*<sup>13</sup>

### 2.3.2 Shkalla krahasore

Shkalla krahasore ka për bazë gjithmonë një krahasim. Ndajfolja në shkallën krahasore tregon se gjymtyra e dytë e krahasimit është në një shkallë më lartë apo më ulët se gjymtyra e dytë, ose është në të njëjtën shkallë me këtë gjymtyrë. Pra, nga kjo kuptojmë se kemi ndajfolje në shkallën krahasore të barazisë dhe shkallë krahasore të pabarazisë.

#### I. Shkalla krahasore e barazisë

Ndajfolja në këtë shkallë tregon që gjymtyra e parë e krahasimit është në të njëjtën shkallë me gjymtyrën e dytë.

Shembull: *Genti reciton aq bukur sa Arta.*

---

<sup>13</sup>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 366-368

## II. Shkalla krahasore e pabarazisë

### ○ Shkalla krahasore e sipërisë relative

Ndajfolja në shkallën e parë të krahasimit të sipërisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është një shkallë më lartë se gjymtyra e dytë. Gjymtyra e dytë është e ndërtuara nga lidhëzat: **se** ose **nga**, dhe mund të jetë një fjali krahasore.

Shembull : *Astriti bërtiste **më fort se** babai i tij.*

Ndajfoljet në këtë shkallë të sipërisë mund të paraprihen nga ndajfoljet **shumë** dhe **pak** e cila tregon se gjendja e gjymtyrës së parë të krahasimit është me e lartë se ajo e masës së dytë në masa të ndryshme.

Shembull: *Ajo dinte **shumë më tepër se** shoqja e saj.*

Për të treguar një rritje përpjestimore të shkallës në të dyja gjymtyrët, ndajfolja në shkallën krahasore të sipërisë shoqërohet me lidhësen **sa**, e cila lidhet në gjymtyrën e dytë me ndajfoljet e sasisë **aq** dhe **kaq**.

### ○ Shkalla krahasore e ultësisë

Ndajfolja në shkallën krahasore të ultësisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit qëndron në një shkallë më të ulët se gjymtyra e dytë. Shqipja letrare e jep idenë e krahasores së ultësisë me mohimin e shkallës krahasore të barazisëme ndërtimet e tipit **jo aq...sa**, ose **nuk (s`)** + **folje** + **aq** + **ndajfolje**.

Shembull: *Mirani notonte në det **jo aq shpejtë sa** motra.*

### 2.3.3 Shkalla sipërore

Ndajfolja në këtë shkallë tregon se cilësia apo intensiteti i veprimit është në një shkallë më të lartë. Shkalla sipërore e ndajfoljeve ndërtohet në mënyrë analitike me ndihmën e ndajfoljeve: *shumë (më shumë), fort, tepër, mjaft, fare, krejt.*

Shembull: *Mësuesja fliste shumë rrjedhshëm.*

- ✓ Për një spjegim më të lehtë të shkallëve të ndajfoljeve kemi shembullin:

Shkalla pohore → *Driloni punon bukur.*

Shkalla krahasore

- e barazisë → *Driloni punon aq bukur sa Bardhi.*
- e sipërisë → *Driloni punon më bukur se Bardhi.*
- e ultësisë → *Driloni punon jo aq bukur sa Bardhi.*

Shkalla sipërore → *Driloni punon shumë bukur.*<sup>14</sup>

<sup>14</sup> Bahri Beci, “Gjuha Shqipe 7”, Pejë, 2004, fq.121

## 2.4 Formimi i Ndajfoljeve

Mënyrat e ndërtimit të ndajfoljeve janë të shumta. Ndajfoljet e shqipes për nga përbërja apo formimi i tyre mund të jenë fjalë të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe lokucione.<sup>15</sup>

### 2.4.1 Ndajfolje të parme

Janë fjalë të parme ato ndajfolje të cilat tema e tyre përbëhet vetëm nga rrënja, të tilla janë ndajfoljet: *lart, poshtë, afër, larg, shumë, pak, tepër, mjaft, tej, etj.* Si fjalë të parme do merren edhe ndajfoljet e tipit: *atje, aty, ashtu, kështu, etj.*, si dhe ndajfoljet e tipit: *mirë, keq, bukur, lehtë, gjatë, shkurt, etj.*

### 2.4.2 Ndajfolje të prejardhura

Ndajfoljet e prejardhura në mënyrë të veçantë janë pasuruar me fjalë të tjera me anë të prapashtesave, me anë të konversionit, me ndajfoljorizimin e pjesëve të tjera të ligjeratës, sidomos të emrave, të mbiemrave të emëruar, të pjesorëvetë foljes të formës së pashtjelluar mohore të tipit “pa pushuar”.<sup>16</sup>

## 1. Ndajfolje të formuara me anë të konversionit nga pjesët e tjera të ligjeratës

- I. Ndajfoljëzimi i emrave do të thotë kalimi nga pjesët e ndyshueshme të ligjeratës në pjesët e pandryshueshme të ligjeratës që tani e merr një kuptim të ri dhe shndërrohet në ndajfolje. Zakonisht emrat që kthehen në ndajfolje janë emra të rasës kallëzore, rrjedhore dhe rrallë të rasës emërore.

Sipas shkallës së ndajfoljëzimit, emrat që përdoren si ndajfolje ndahen në disa kategori:

---

<sup>15</sup> Shaban Demiraj, “Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974, fq. 194

<sup>16</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 370

- Grupin më të shpeshtë përbëjnë fjalët në rasën rrjedhore si: *motit, sheshit* dhe në rasën kallëzore si: *rrafsh, rresht, rreth, rrotull, vjet* të cilat përdoren rregullisht si ndajfolje. Disa me prejardhje emërore janë: *fare, herët, krejt*.
- Një grup fjalësh që procesi i ndajfoljësimit nuk është konsoliduar merren si formë emërore si ato të tipit: *ditën, natën, anash* si dhe të tipave: *një ditë, një natë, një kohë, një mëngjes*, etj.
- Një grup të veçantë përbëjnë fjalët që lidhen me formën e ngurosur të rrjedhores së mbiemrave të emëruar asnjans të tipit: *së afërmi, së brendshmi, së bashku, së gjati, së largu, së mbari*, etj., që përdoren rregullisht si ndajfolje. Ndajfoljet e këtij tipi kanë humbur çdo lidhje me klasën e mbiemrave të emëruar, nga edhe kanë dalë.
- Një grup të veçantë përbëjnë emrat që vetëm në kontekste të caktuara përdoren si ndajfolje. Janë kryesisht emrat në rasën emërore e rrallë herë në kallëzore. Ndajfoljësimit i këtyre emrave është arritur nëpërmjet një krahasimi. Disa emra që në raste të caktuara mund të përdoren si ndajfolje janë: *copë, faqe, grumbull, lëmsh, palë, varg, vrap*, etj.

Shembull: *Puna shkoi lëmsh me reformën e re.*

- II. Ndajfoljësimit i foljeve, format foljore që përdoren në funksionin e ndajfoljes, i humbasin veçoritë leksikore e gramatikore të klasës prej nga vijnë dhe formojnë tipare leksikore gramatikore të klasës së ndajfoljeve. Pjesorët e foljeve si ndajfolje përdoren në funksionin e rrethorëve të mënyrës. Pra, merren si ndajfolje:
- padashur, hapur, fshehur, kaluar, prerë, rëmbyer*, etj.

Shembull: *Jupi i sulmoi hapur para të gjithë të pranishmëve ata vagabondë*.<sup>17</sup>

## 2.Ndajfolje të formuara me prapashtesa

Kemi ndajfolje që formohen nga prapashtesat dhe janë mjaft prodhimtare. Prapashtesat më karakteristike që përdoren më tepër janë: - **(i)sht**, **-as/-azi**, dhe **-thi**. Në gjuhën e folur karakteristike është prapashtesa **-çe**. Ndajfoljet në gjuhën e sotme letrare përmbajnë prapashtesën **-shëm**. Me anë të prapashtesës formohet kryesisht ndajfolja e mënyrës.

- I. Prapashtesa **-(i)sht** është më prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Ajo lidhet kryesisht me tema jo të parme që mbarojnë me *-i*, duke dalë kështu prapashtesa

<sup>17</sup>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Gramatika e Gjuhës Shqipe I", Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë,2002, fq.371- 372

në trajtën –sht. Për analogji, për këtë janë formuar ndajfolje edhe nga tema fjalëformuese që nuk mbarojnë me –i, duke u zgjeruar me prapashtesën –isht si: *natyrisht, trimërisht*, etj. Me të janë formuar ndajfolje:

Shembull: *Mirjani i përballoi **burrërisht** të gjitha vështirësitë.*

- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën -(ë)si, si: *fatmirësisht, hollësisht, egërsisht, gjerësisht, imtësisht* etj;
- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën -(ë)ri, si: *trimërisht, burrërisht, besnikërisht, pleqërisht*, etj;
- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën -i, si: *bujarisht, njerëzisht, dhelpërisht* etj. Si dhe ndajfoljet që përdoren nga gjuha e popullit apo dialekti si: *arbërisht, çamërisht, bullgarisht*, etj.;
- nga emra abstraktë të gjinisë mashkullore të formuar me prapashtesë -im, si: *qëllimisht, gabimisht, përfundimisht, detyrimisht*, etj.;
- nga një numër i kufizuar emrash të parmë të gjinisë femërore e mashkullore, si: *natyrisht, rregullisht, zakonisht*.

Një kategori e gjërë ndajfoljesh është formuar nga bashkimi i prapashtesës -(i)sht me tema fjalëformuese mbiemërore. Të tilla janë ndajfoljet: *absolutisht, artistikisht, mesatarisht, ushtarakisht*, etj. Në formimet ndajfoljore të këtij tipi mbizotërojnë ato që janë formuar mbi bazën e temave të mbiemrave të huazuar nga gjuhë të tjera.

I. Një prapashtesë tjetër prodhimtare është prapashtesa -as/-azi.

Shembull: *Dy shoqet u rrokën **fytazi** me njëra-tjetrën.*

Ajo bashkohet:

- me tema emërore të parme si: *barkas e barkazi, doras, fytas e fytazi, radhas e radhazi* etj.;
- me tema mbiemërore si: *anasjelltas, fshehtazi, majtas e majtazi, djathtas e djathtazi*, etj.;
- me tema ndajfoljore si: *haptazi, keqas, lartas e lartazi, shkurtas e shkurtazi*, etj.;
- me tema foljore si: *befas, falas, ndarazi, shkarazi, fshehuras e fshehurazi*, etj.;
- me tema jo te parme si: *këmbadoras (-azi), doradoras (-azi)*, të cilat janë formuar me përngjitje apo përbërje dhe me prapashtesë njëkohësisht.



II. Prapashtesa *-thi* bashkohet:

Shembull: *Ishin mbledhur fëmijët e lagjës dhe luanin cingëlthi me njëri-tjetrin.*

- me tema emërore të parme: *topthi, arithi, cingëlthi, trupthi, qirithi, mullarthei*, etj. Kjo prapashtesë përdoret më shpesh për emërtimin e lojërave të ndryshme.
- me tema emërore jo të parme të formuara me prapashtesën *-im*: *fluturimthi, nxitimthi, kalimthi, rrëmbimthi*, etj. Në këto raste prapashtesa bashkë me temën tregon se veprimi kryhet në mënyrë të shpejtë e të menjëhershëm.
- me tema mbiemërore: *çalamanthi, qorthi*.
- me tema ndajfoljore: *përsëprapthi, rrëshqanthi*.

Ndajfoljet që janë formuar me prapashtesën *-thi* dhe me përngjitje në të njëjtën kohë janë: *pulaqorrthi, symbyllthi, brezahypthi*, etj., që emërtojnë lojëra të ndryshme dhe lidhen kryesisht me këtë sferë.

- III. Disa lloje të ndajfoljeve kanë prapashtesën *-shëm* të cilat përputhen me trupin e mbiemrave me këtë prapashtesë, por ka një prirje për të zhvilluar ndajfolje të tilla pavarësisht nga mbiemrat. Te tilla janë: *fuqishëm, furishëm, gëzueshëm, hareshëm, mendueshëm, natyrshëm, rrjedhshëm, mallshëm*, etj.
- IV. Ndajfoljet me prapashtesën *-çe*, me burim nga turqishtja janë formuar disa ndajfolje me tema emërore si: *budallallëkçe, çapkënçe, fshatarçe*, etj. Kuptim përqeshës që karakterizohen disa nga këto ndërtime, lidhet fort me temën me të cilën bashkohet prapashtesa. Në shumë vende, vendin e saj e ka zënë prapashtesa *-(i)sht*.
- V. Ndajfoljet me prapashtesën *-sh*, që vine nga shndërrimi i morfemës trajtëformuese të rrjedhore në prapashtesë, si: *cingulash, kukullash, luftash, vizash, petash*, etj.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 373-376

### 2.4.3 Ndajfoljet e përngjitura

Grupin më të madh të ndajfoljeve e përbëjnë ndajfoljet e përngjitura të një togfjalëshi, ku një pjesë përbërëse është përemër. Sipas elementeve përbërëse, dallohen disa grupe strukturore ndajfoljesh të përngjitura:

- Ndajfolje të përngjitura përemërore: Në këtë grup, element i parë i përngjitjes është përemri *gjithë*, ndërsa element i dytë mund të jetë ndajfolje përemërore, një emër apo një pjesë tjetër e ligjeratës. Të tilla janë: *gjithandej, gjithashtu, gjithherë, gjithnjë*.
- Ndajfolje të përngjitura përemërore. Element i parë i përngjitjes është një nga ndajfoljet përemërore pyetëse *kur, ku, nga, si, qysh, tek*, ndërsa element i dytë folja *do*. Të tilla janë: *kurdo, kudo, ngado, sido, qyshdo, tekdo*.
- Ndajfolje të përngjitura që si element të parë kanë një përemër apo një ndajfolje e një pjesëz, kurse si element i dytë të përngjitjes del ndajfolja përemërore *kund* apo *kundi*. Të tilla janë: *asgjekundi, askund, askurrkund, kurrëkund, gjekundi, tjetërkund*.
- Ndajfolje të përngjitura që si element i parë kanë një parafjalë, ndajfolje, përemër ose pjesëz, kurse element i dytë i përngjitjes del emri *herë*. Të tilla janë: *asnjëherë, atëherë, menjëherë, ngaherë, nganjëherë, përherë, përnjëherë*.
- Ndajfoljet e përngjitura të cilat janë të formuara nga një parafjalë dhe një emër, dhe elementi i dytë i përngjitjes, emri është gjithmonë në trajtën e pashquar. Të tilla janë: *përballë, përmes, përqark, përreth, përditë, përnatë, përherë*, etj.
- Ndajfoljet e përngjitura elementët përbërëse të cilat i kanë dy emra të lidhur me apo pa zanore lidhëse. Këto formime sot merren si fjalë të përbëra. Të tilla janë: *fytafyt, kryekëput, motmot, shpeshherë, rrallëkund, buzagaz*, etj.
- Ndajfoljet e përngjitura të formuara nga një numëror dhe emri *fije (fill)*, në rrjedhoren e pashquar shumë me mbaresën *-sh*. Këto ndajfolje mund të merren edhe si formime prapashtesore. Të tilla janë: *dyfish, trefish*.
- Ndajfolje të përngjitura me pjesë të ndryshme të ligjeratës si elemente përbërëse. Të tilla janë: *ndërkaq, sakaq, dosido, njëlloj, kësisoj, kësodore, sidokudo, vetvetiu* etj.

### 2.4.4 Lokucione ndajfoljore

Me lokucione ndajfoljore nënkuptojmë një grup fjalësh që kanë një lidhje të qëndrueshme në mes tyre. Lokucioni ndajfoljor ashtu si kuptimisht edhe gramatikisht zë një pozitë të ndërmjetme midis togut apo togfjalëshit të lirë dhe të fjalës. Pas disa kohe, lokucionet

ndajfoljore përfundojnë në fjalë të përngjitura.

Në gjuhën shqipe kemi mjaft lokucione ndajfoljore por që nga ana e strukturës janë të ndryshme. Kemi lokucione ndajfoljore që janë të formuara me përsëritje të tipave të ndryshëm:

1. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër të lidhur me lidhësen *e*. Por ka edhe lokucione ndajfoljore të formuara nga bashkimi idy emrave me kuptim të afërt sinonimik. Këto lokucione tregojnë mënyrën e kryerjes së një veprimi, apo kanë kuptim kohor. Të tilla janë: *anës e anës, varg e varg, copë e çikë, ditë e natë, natë e ditë, fund e kryje, hundë e buzë, orë e çast, verë dimër, natë ditë etj.*

Lokucionet ndajfoljore formohen edhe nga bashkimi i ndajfoljeve me kuptim antonimik, të lidhura ose jo me lidhësen *e* : *aty-këtu, andej-këtej*. Ose me përsëritjen e së njëjtës ndajfolje me lidhësen *e* : *shpejt e shpejt, pranë e pranë, mirë e mirë*. Kjo përsëritje nganjëherë merr vlerën e shkallës sipërore.

2. Me lokucione ndajfoljore lidhen pjesët që janë të formuar nga përsëritja e drejtëpërdrejtë e një emri në formën e numrit shumës, të tilla janë: *copa-copa, fije-fije, flokë-flokë, gropa-gropa, palë-palë, pjesë-pjesë, valë-valë, shkallë-shkallë, tufë-tufë*. Përsëritjet e këtij lloji tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit dhe rrallë tregojnë rrethana kohe dhe vendi.

Mund të formohen lokucione ndajfoljore edhe nga përsëritja e së njëjtës ndajfolje pa lidhësen *e* si: *hollë-hollë, rëndë-rëndë, shumë-shumë*.

3. Njëjtë si lloji i mësipërm lidhen pjesët e formuara nga përsëritjet në trajta të ndryshme të tipit *emër në emëroren e shquar njëjës + emër në dhanoren e shquar*. Të tilla janë: *dita-ditës, dora-dorës, gryka-grykës, gjurma-gjurmës, hera-herës, këmba-këmbës, nata-natës*.
4. Lokucione ndajfoljore të cilat janë të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër me ndërmjetësinë e paraafjalëve të ndryshme.

a) Nga përsëritja e një emri me *ndërmjetësinë e paraafjalës për*:

- për të treguar kohën e kryerjes së një veprimi të përsëritur: *ditë për ditë, javë për javë, orë për orë, natë për natë, vit për vit, mot për mot etj.* ;
- për të treguar mënyrën e kryerjes së një veprimi: *ballë për ballë, dorë për dorë, fjalë për fjalë, fyt për fyt, krah për krah etj.*

b) Nga përsëritja e një emri me *ndërmjetësinë e paraafjalës më*:

- për të treguar vendin e kryerjes së veprimit: *degë më degë, rrugë më rrugë, skaj më skaj, breg më breg, shpat më shpat, shteg më shteg* etj. ;
- për të treguar mënyrën e kryerjes së veprimit: *buzë më buzë, gojë më gojë, kokë më kokë, vesh më vesh*, etj.

c) Nga përsëritja e një emri me *ndërmjetësinë e parafjalës pas*. Gjymtyra e parë është në emërore të pashquar ndërsa e dyta në rrjedhore të pashquar. Të tilla janë lokucionet: *brez pas brezi, ditë pas dite, herë pas here, hap pas hapi, kohë pas kohe* etj.

d) Lokucionet e formuara nga përsëritja e të njejtimit emër një lloj të veçantë e përbëjnë ndërtimet *parafjalë (nga) + emër në rasën emërore të shquar + parafjalë (në) + emër në kallzore të pashquar*. Të tilla janë lokucionet: *nga dita në ditë, nga çasti në çast, nga koha në kohë, nga viti në vit*, etj.

5. Lokucione ndajfoljore të formuara nga një parafjalë dhe një numëror ose nga përsëritja e një numërori me *ndërmjetësinë e një parafjale: për një, për dy, për tre; në dysh, në tresh, në katërsh; një nga një, dy nga dy*, etj., të cilat tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit.
6. Lokucione ndajfoljore të tipit *ndajfolje + parafjalë + ndajfolje: aty për aty, drejt për drejt, kot më kot, pak nga pak, sot për sot, vetëm për vetëm* etj., të cilat tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit.
7. Lokucione ndajfoljore të formuara nga *parafjala me* dhe një mbiemër i emëruar i gjinisë asnjësore: *me të butë, më të mirë, me të qeshur, me të shpejtë, me të urtë*, të cilat tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit.  
Një tip të veçantë e përbëjnë lokucionet ndajfoljore të formuara me *parafjalën për* dhe me një mbiemër të emëruar të gjinisë asnjësore të rasës rrjedhore: *për së gjalli, për së gjati, për së largu*, etj.
8. Lokucione ndajfoljore të formuara nga një parafjalë dhe një emër i pashquar dhe të shndërruar si kuptimisht dhe gramatikisht në një njësi të qëndrueshme dhe të pandashme, me vlerë dhe tipare ndajfoljore: *me kohë, me ngut, me pahir, me radhë, me vrap, për bukuri, prej kohësh, më këmbë, në tym* etj.<sup>19</sup>


<sup>19</sup>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë, 2002, fq. 376-380

### 3. JETA DHE VEPRA E AUTORIT

#### 3.1 Qamil Batalli

Qamil Batalli u lind në Prishtinë më 1 Shkurt 1936. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje kurse fakultetin Filozofiko - Historik në Beograd . Ai njihet si poet i shquar, mësues – pedagog për fëmijë, studiues i letërsisë, hartues i Abetares dhe prozator. Me letërsi filloi të merrej që nga bankat e shkollës. Punimi i parë iu botua në revistën “Rilindja” – 1954. Botimet gjatë kësaj kohe ishin të vështira, koha e shpërnguljeve më dramatike dhe tragjike nga teroret më të egra të zbatuara nga pushtuesit serb. Qamili është njëri ndër shkrimtarët tanë më të shquar për fëmijë. Ai asnjëherë nuk u ndal së shkruari, botoi libra e shkroi nëpër gazeta të ndryshme si “Rilindja” , “Bujku”, “Jeta e Re”, “Pioneri”, “Zëri i rinisë”, “GEP”, “Kosovarja”, etj.

Veprat e Qamil Batallit: ”Buzëqeshjet”- tregime për fëmijë, 1966; “Dëshira”- tregime për fëmijë, 1967; “Abetare”,- libër leximi për klasën e parë të shkollës fillore, 1982; “Tregime të zgjedhura për fëmijë”-1984; “Gentiana”- libër parashkollor, 1998; “Djaloshi i çuditshëm”- tregime për fëmije, 2003; “Shoku im Learti”- tregime me ngjarje të vërteta për fëmijë, 2008; etj. Ai ndërroi jetë më 18 Janar 2009 në Prishtinë.




**QAMIL BATALLI** <sup>20</sup>

<sup>20</sup>[http://www.qamilbatalli.com/wp-content/uploads/2019/06/revista-model\\_final.pdf](http://www.qamilbatalli.com/wp-content/uploads/2019/06/revista-model_final.pdf)

### 3.2 Vepra “ Djaloshi i çuditshëm”

Qamil Batalli është njohur ndër ne si shkrimtar që ka shkruar shumë vepra për moshën e fëmijëve. Të shkruash libra, romane apo tregime për fëmijë nuk është punë e lehtë. Shkrimtarit në raste të tilla i nevojitet që të jetojë me psikologjinë dhe botën e fëmijëve dhe të kuptojë mentalitetin e tyre. Përmes shkrimeve të tij, autori përpiqet që të kultivojë një shkallë të edukimit të fëmijët. Personazhet e këtij libri “Djaloshi i çuditshëm” që kam pasur në shqyrtim gjatë këtij punimi, i takojnë periudhës fëmijërore në të cilën paraqitet edhe mendimi dhe psikologjia e tyre. Nga tregimi në tregim, autori përshkruan ngjarje të ndryshme të cilat kanë një karakter edukativ dhe human për përgatitjen e brezit të ri që të hyjë në shoqëri në mënyrë sa më dinjitoze dhe për të qenë të sukseshëm në jetë. Është karakteristike se edhe emrat e personazheve të cilët i zgjedh shkrimtari për t’i përshkruar në libër janë emra të rinj, kryesisht me kuptim shqip dhe të kuptueshëm nga të gjithë, si psh.: Liriani, Gentjana, Durim, Teuta, Hirushja, Etriri, Fatushe, Rrezan, Bardhan, Drita, Drinore, Tulirani, Sokol, Ardi, Bardhi, Dushkani, Floriza, Blinare, Gent, Arta, Astrit, Miraku, Bjeshkani, Blerani, Dukurani, Adamati, Gazmend, e shumë emra të ngajshëm të imagjinuar prej autorit. Përmes këtyre emërtimeve, shkrimtari Qamil Batalli është përpjekur që të krijojë një edukatë dhe prirje për përdorimin e emrave vetjak nga Gjuha Shqipe, dhe ky është një kontribut i veçantë. Përmes veprimit të personazheve të përshkruar në këtë vepër, autori përpiqet të kultivojë tek të rinjtë dashurinë për jetën, respektin ndaj prindërve, dashurinë për atdheun si dhe guximin për të arritur rezultate sa më të larta dhe për të realizuar objektivat e jetës. Prandaj ,kjo vepër ka një vlerë të veçantë dhe është shumë e nevojshme që të lexohet sa më shumë nga fëmijët.



## PËRFUNDIMI

Çfarë kemi në mendje dhe në zemër e transmetojmë përmes komunikimit, pra mjeti themelor i komunikimit është gjuha.

Degët kryesore të gjuhës janë: fonetika, leksikologjia dhe gramatika (e ndarë në morfologji dhe sintaksë), të cilat janë të ndërlidhura në mes vete.

Ky punim fokusohet tek ndajfolja e cila është pjesë e pandryshueshme e ligjeratës që emërton një tipar të një veprimi apo gjendjeje. Ajo klasifikohet sipas funksionit që kryen në fjali në ndajfolje përcaktore dhe në ndajfolje rrethimore. Në ndajfoljet përcaktore hyjnë: ndajfoljet e mënyrës dhe sasisë kurse në ndajfoljet rrethimore hyjnë: ndajfoljet e kohës, vendit dhe shkakut.

Ashtu sikurse mbiemrat, edhe ndajfoljet kanë një veçori që nuk e kanë pjesët tjera të ligjeratës, ajo është aftësia për t'u përdorur në shkallë të ndryshme.

Përmes këtij punimi, jam munduar të paraqes spjegimin e ndajfoljes duke marrë shembuj nga libri i përzgjedhur për fëmijë “Djaloshi i çuditshëm”, i cili ka karakter edukativ për kultivimin e dashurisë ndaj atdheut dhe sjelljeve të mira në rrethin shoqëror.

## LITERATURA

- Shaban Demiraj, “ Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fonetika – Morfologjia”, Botimi “Progres” Mitrovicë, 1974.
- Shaban Demiraj, “Morfologjia Historike e Gjuhës Shqipe”, Botimi “Ramiz Sadiku” Prizren, 1980.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e Gjuhës Shqipe I”, Botimi I Akademise së Shkencave Tiranë,2002.
- Bahri Beci, “Gjuha Shqipe 7”, Pejë,2004.
- Bahri Beci, “Gramatika e Gjuhës Shqipe” Tiranë, 2010.
- Gjovalin Shkurtaj, “Shqipja e Sotme”, Shtëpia Botuese Universitare U.F.O Press,Tiranë,2010.
- [http://www.qamilbatalli.com/wp-content/uploads/2019/06/revista-model\\_final.pdf](http://www.qamilbatalli.com/wp-content/uploads/2019/06/revista-model_final.pdf)



## LEKTORIMI

Deklaroj se kam lektoruar temën për **BACHELOR** me titull: **ANALIZË MORFOLOGJIKE E NDAJFOLJEVE NË VEPRËN “DJALOSHI I ÇUDITSHËM”- QAMIL BATALLI** të kandidatës **Arnisa Rogova**

Lektore e Gjuhës shqipe:

**Rilinda Mati**

Nënshkrimi:

\_\_\_\_\_

**Gjakove, 2020**